



RAPORTI PËRMBLEDHËS : “Itinerari kulturor - Gjurmët Fishtiane”

PROJEKTI I MUZEALIZIMIT TË OBJEKTIT KU AT GJERGJ FISHTA KALOI VITET E
PARA TË JETËS

Ark. Enola Martopullo

Pros.asoc.dr. Lili SULA

Z. Frano Kulli

Z.Albion Zifla

PËRMBAJTJA.....	2
AT GJERGJ FISHTA	3
PROJEKTI I MUZEALIZIMIT TË OBJEKTIT KU GJERGJ FISHTA KALOI VITET E PARA TË JETËS.....	3
METODOLOGJIA E NDËRHYRJES.....	4
AKSESIBILITETI	6
ORGANIZIMI FUNKSIONAL	11
KËRKESA PËR LEJE APO LICENCA.....	17
LISTA E FIGURAVE.....	20

AT GJERGJ FISHTA

PROJEKTI I MUZEALIZIMIT TË OBJEKTIT KU GJERGJ FISHTA KALOI VITET E PARA TË JETËS

Banesa ku At Gjergj Fishta ka jetuar vitet e para të jetës, është një ngrehinë dy katëshe e gjithame mure guri të plotë. Kjo ngrehinë është vendosur brenda një oborri të rrethuar, i cili ka një disnivel të vogël kuotash brenda rrethimit të tij. Banesa e vjetër ka pasur dy ambiente në katinpërdhe dhe tre në katin e parë. Nën veprimin e kohës dhe agjenteve të ndryshëm atmosferik, para restaurimit, paraqiste një gjendje fizike të rënduar. Restaurimi i përfunduar në vitin 2020 e ka kthyer atë në gjendjen fillestare, duke i dhënë këtij objekti statusin e merituar si monumentkulture i kategorisë së dytë.



Fig. Nr. 1 Shtëpia ku ka jetuar vitet e para

At Gjergj Fishta ka qënë një figurë qendrore e veprimtarisë fetare, letrare e artistike, si dhe politiko-diplomatike të kohës në të cilën ka jetuar. Konceptimi i muzealizimit të një hapësire me në qendër një figurë të tillë shumëdimensionale, kërkon një qasje në të cilën të paraqiten samë të plota të gjitha dimensionet e figurës së tij. KONCEPTI i organizimit të këtyre hapësirave funksion të muzealizimit konsiston në krijimin e një rrugëtimi sa fizik aq dhe shpirtëror. Pikërisht ndarja e ambienteve sipas veprimtarive kryesore që ka ushtruar gjatë jetës së tij At Gjergj Fishta, është baza e organizimit të këtij muzeu.





Fig. Nr. 2 Koncepti i muzealizimit të hapësirës

Një nga sfidat që hasin sot hapësirat muzeale është fakti që nuk mund të jenë vetëm hapësira të cilat shpërndajnë një informacion të caktuar në secilin nga ambientet e tij, por duhet të vendosin në qendër vizitorin dhe nevojat e tij. Për këtë arsye, duke përdorur teknikat bashkëkohore audio-vizuale, në zona të caktuara është propozuar një përjetim interaktiv i hapësirës dhe/ose i veprimtarisë së At Gjergj Fishtës.

Duke qënë se informacionet për Fishtën dhe veprimtarinë e tij janë të shumta dhe të larmishme, dhe ngrehina e propozuar për muzealizim është mjaft e vogël, këto metoda teknologjike audio-vizuale ndihmojnë në perceptimin më të plotë të kësaj figure.



Koncept-idea e hapësirës

Fig. Nr. 3 Koncepti i organizimit të odave

Dhomat përbërëse të banesës janë quajtur oda, sipas mënyrës së emërimit të tyre në dialektin e zonës ku ndodhet objekti. Këto oda janë organizuar në dy mënyra, sikurse janë paraqitur në figurën e mësipërme. Mënyra e parë është ekspozimi i informacionit në faqet e odës duke e vendosur vizitorin në qendër, ndërsa mënyra e dytë është vendosja e informacionit në qendër duke bërë lëvizjen e vizitorit për qark tij.

Një tjetër qasje që është mbajtur në konsideratë gjatë hartimit të projektin të muzealizimit është ndërthurja e tradicionales me bashkëkohoren. Kështu, ndërsa mënyra e ekspozimit është mjaft teknologjike dhe bashkëkohore mobiljet e propozuara mendohet të jenë tradicionale. Për konceptimin e këtyre mobiljeve janë marrë si referencë mobiljet tradicionale të zonës së Zadrimës, me ngjyrat e tyre të ndezura dhe gdhendjet në dru.

Banesa ku Fishta ka kaluar vitet e para të jetës së tij është i organizuar në dy kate. Në katin përdhe gjenden dy dhoma dhe një korridor, në të cilin është pozicionuar dhe shkalla, ndërsa në katin e sipërm kemi korridorin dhe tre dhoma. Lëvizja e propozuar nëpër këtë objekt është paraqitur me hapat përkatës në figurën e mëposhtme.




Fig. Nr. 4 Aksesibiliteti

Si hap i parë për aksesin në hapësirën muzeale është propozuar shtesa e një objekti me funksionbiletari dhe zonë tregtimi suvenieresh. Nevoja e shtimit të kësaj hapësire vjen si pasojë e sipërfaqes shumë të vogël dhe të pamjaftueshme brenda ngrehinës ekzistuese. Distanca nga hyrja kryesore e objektit tek shkallët është 2 m, ndërkohë që dimensionin në drejtimin tjetër është afërsisht 1.9 m. Këto dimensionet janë të mjaftueshme për të siguruar lëvizje komode për në ambientet e katin përdhe, pa ndikuar në fluksin e lëvizjes për në katin e parë.

Shtimi i zonës së biletarisë brenda ngrehinës ekzistuese, duke patur parasysh dimensionet e sipërpërmendura, është i pamundur funksionalisht. Gjithashtu, një propozim i tillë bën të vështirë qarkullimin brenda ambientit ekzistues, pasi do të gjendej pikërisht në kryqëzimin e flukseve të lëvizjes.



Fig. Nr. 4 Plan Sistemimi

Duke u nisur nga fakti që brenda oborrit të rrethuar ku ka qënë një objekt ekzistues, funksioni i të cilit ka qënë në ndihmë të banesës kryesore, objekti i shtuar është propozuar me përmasa të ngjashme me të. Pozicionimi i tij është menduar jashtë oborrit ekzistues për të dhënë më tepër frymëmarrje hapësirës së jashtme të shtëpisë muze, por në të njëjtën kohë në afërsi të rrethimit të tij. Fasada e objektit të ri është menduar e veshur me gur, me qëllimin që të ketë harmoni vizuale me objektet e tjera të zonës. Përveç biletarisë, në objektin e shtuar është propozuar edhe një ambient për shitjen e suvenirëve të ndryshëm, botimet e veprës së plotë të Fishtës, punimet e zonës së Zadrimës, etj. Në zgjidhjen e interiorit të propozuar, biletaria dhe zona e shitjes së suvenirëve janë të shkrira në një.



Fig. Nr. 5 Render nga objekti i propozuar



Fig. Nr. 6 Render nga objekti i propozuar



Fig. Nr. 7 Render nga objekti i propozuar



Fig. Nr. 8 Render nga objekti i propozuar

Në pjesën e pasme të oborrit ndodhet një objekt ekzistues, të cilin e kemi propozuar të ketë funksionin e nyjes higjeno-sanitare. Në ngrehinën origjinale nyja higjeno sanitare ka qënë vendosur në krah të objektit, shtesë e cila pas restaurimit nuk është bërë. Për këtë arsye, mendojmë të përshtatet në funksionin e nyjes higjeno sanitare, objekti ekzistues i ndodhur në pjesën e pasme të oborrit.



Fig. Nr. 9 Foto e objektit në pjesën e pasme të oborrit




Fig. Nr. 10 Skema e organizimit funksional

ORGANIZIMI FUNKSIONAL

Me shtimin e një objektit të ri, është menduar rikualifikimi i gjithë pjesës së hyrjes në zonën emuzeut. Kështu, disniveri i theksuar i terrenit para rrethimit të tij është menduar të sistemohet me anë të një shkallare, ku shkallët janë të vendosur në grupe katër apo pesë shkallësh me lartësi 16 cm. Kjo shkallare është menduar të ketë ndriçim pas rënies së diellit.

Përballë objektit të ri vizitorët njihen, me anë të tabelave informuese, me pozicionimin e tyre në itinerarin e rrugëtimit fishtian. Informacioni i vendosur është pozicionimi i kësaj pike kryesore në raport me tërësinë e vendndodhjeve të rëndësishme ku Fishta ka jetuar e ushtruar aktivitetin e tij si një figurë shumëdimensionale, si dhe një tabelë informuese me të dhënat e përgjithshme të vendit.

Pasi hyn në rrethimin ekzistues, përgjatë rrugës që të çon në hyrjen e objektit është vendosur një material informues për jetën e At Gjergj Fishtës, që nga lindja, familja, momentet kyçe të jetës, shoqëruar me informacione dhe imazhet përkatëse. Ky informacion vjen e ekspozuar sipas një renditje kronologjike të shpërndara në katër tabela informuese.

Në momentin e parë të hyrjes brenda ngrehinës, është propozuar të vendoset një portret i stilizuar me mjete shprehëse të përzgjedhura dhe të paraqitura nga një artist. Mbi të është vendosur manifesti që ka shoqëruar At Gjergj Fishtën gjatë gjithë jetës së tij: *Për Fe, Kulturë, Atme*.

Në dhomën e parë, të quajtur ODA 1, duke iu përmbajtur fjalorit të banesave tradicionale, është paraqitur organizimi i një dhome tradicionale të zonës së Zadrimës, ku janë pozicionuar karriget rreth vatrës së zjarrit. Karriget e përzgjedhura janë karrige tradicionale të zonës së veriut, madhështia e të cilave qëndron mirë me figurën e At Gjergj Fishtës.

Në të majtë të hyrjes është vendosur një gramafon, në vinilin e të cilit dëgjohet gjatë gjithë kohës recitimi i “Lahutës së Malcís” me zërin e At Gjergj Fishtës. Gramafoni qëndron mbi një mobilje xhami të temperuar. Përballë tyre, është vendosur një mobilje tradicionale e zonës së Zadrimës. Kjo dhomë të përcjell ngrohtësinë e dhomës së zjarrit të kohës kur ka jetuar At Gjergj Fishta.




Fig. Nr. 11 Oda 1




Fig. Nr. 12 Oda 2

ODA 2 i është e dedikuar aktivitetit fetar të At Gjergj Fishtës, si një nga pjesët më të rëndësishme të jetës së tij. Në faqen ballore të kësaj dhome kemi ekspozimin e veshjes karakteristike të fratrëve franceskan që At Gjergj Fishtën e ka shoqëruar gjithë jetës. Në të majtë të hyrjes së odës 2, informacionet dhe materialet fotografike janë organizuar në 4 panele cope të kapura në tavan dhe dyshe me kapëse metalike. Përballë kësaj hapësire është vendosur një stol i punuar që të kujton karrigen tradicionale të përzgjedhur, e cila është përdorur edhe në odën 1. Ndërkohë që në mur është vendosur një vend për të mbajtur syze/pajisje, të cilat do të shërbejnë për përjetimin e një realiteti virtual. Si i tillë është menduar riprodhimi i meshës së parë të At Gjergj Fishtës, e mbajtur në Kuvendin e Troshanit.




Fig. Nr. 13 Korridor i katit përdhe

Korridorin është një hapësirë e organizuar për ekspozim gjithashtu. Në pjesën qendrore të tij, përbri shkallës kemi një panel xhami me shkrime të ngjitura në të me adeziv. Ky panel është i inkastruar në tavan dhe dyshme duke patur dy funksione të rëndësishme në këtë hapësirë. Një nga funksionet është ai i parapetit të shkallës ndërsa tjetri ka funksion informimi me anë të shkronjave. Në katin përdhe këto shkrime janë të pakta, për shkak të informacionit të gjerë në korridorin e këtij kati. Ndërkohë, vijnë duke u shtuar në katin e parë.

Në qëndër të korridorit ndodhet grafiku i krijmtarisë letrare të At Gjergj Fishtës lehtësisht i evidentueshme. Në fund të korridorit përbri shkallëve është ekspozuar një ndër poezitë me përfaqësues lirike të krijmtarisë së tij: *Një lule vjeshtet*.

Në korridorin e katit të dytë janë vendosur në korniza letërkëmbimet e At Gjergj Fishtës me personalitete të shquara të kohës. Dorëshkrimet origjinale të letërkëmbimeve gjendet tek Provinca Françeskane, si dhe tek Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të Shtetit. Këto letra të ekspozuara si dorëshkrime me anë të njëkodi QR mund të lexohet në telefon, për këdo që është i interesuar në përmbajtjen e tyre dhe ka vështirësi leximi. Në faqen në vijim është vendosur portreti i At Gjergj Fishtës më përfaqësues, ai me të gjithë dekoratat.




Fig. Nr. 14 Korridor i katit të parë




Fig. Nr. 15 Oda 3

Në dhomën e parë pranë shkallës, ndodhet ODA 3. Ajo është organizuar si një ambient ku jetadhe veprimtaria e Fishtës përjetohet në një mënyrë virtualisht më realiste; materialet audio- vizive mund të aksesohen nëpërmjet pajisjeve të vendosura në këtë odë. Këto prezantohet veprimtaria politiko – diplomatike e At Gjergj Fishtës. Në faqen përballë janë vendosur dy fototë mëdha, njëra nga Parlamenti i Parë Shqiptar dhe tjetra nga Konferenca e Paqes në Paris. Këtofoto gjenden përkatësisht tek Arkiva Digjitale Shqiptare dhe tek Fototeka e Muzeut Marubi. Janë përzgjedhur si fotot më përfaqësuese të veprimtarisë politike dhe diplomatike të At Gjergj Fishtës.

Nëqendër të kësaj dhome ndodhet një tavolinë me ekrane tek të cilat mund të paraqiten intervistadhe foto të ndryshme nga veprimtaria politike e At Gjergj Fishtës. Këto ekrane shoqërohen edhe me kufje me anë të të cilave mund të dëgjohen ato që janë paraqitur në ekran. Sugjerohet që për secilin ekran, t

ODA 4 është hapësira ku është paraqitur veprimtaria letrare e At Gjergj Fishtës. Në faqen përballë me hyrjen e kësaj ode janë ekspozuar disa artefakte në lidhje me botime të ndryshme të veprës së Fishtës, si p.sh. Breni i parë i Lahutës së Malcisë, Hylli i Dritës, etj. Në qendër të kësaj ode është vendosur një vend për t'u ulur i shoqëruar me kufje, me atë të cilëve mund të dëgjohen recitime të ndryshme të poezive të Fishtës, të interpretuara p.sh. nga Reshat Arbana ose Çun Lajçi. Në dy faqet anësore janë vendosur përballë njëra-tjetrës informacione mbi veprimtarinë letrare të Fishtës. Në njërën faqe janë renditur titujt e veprave të tij, ndërsa në faqes përballë janë renditur shkrimet mbi Fishtën, duke nxjerr në pah periudhën “bosh” midis viteve '45-'90.




Fig. Nr. 16 Oda 4




Fig. Nr. 17 Oda 5

ODA 5 dhe e fundit, është e dedikuar për veprimtarinë projektuese e artistike të Fishtës. Në këtë odë, do të bëhet e mundur projektimi në të gjithë faqen e veprave të projektuara nga At Gjergj Fishta, sikurse edhe të portreteve të projektuara nga ai. Ky projektion do të bëhet në mënyrë të pandërprerë përse kohë ka një vizitor të pranishëm brenda odës 5.

Me këtë odën mbyllet dhe përjetimi i muzeut të At Gjergj Fishtës. Dalja bëhet nga të njëjtat shkallë. Përveç hyrjes/daljes kryesore në pjesën e pasme të objektit është edhe një dalje dytësore për raste emergjencash, sikurse edhe për të bërë një lidhje me të shkurtër me nyjen higjeno- sanitare.

KËRKESA PËR LEJE APO LICENCA

Zona në studim, në bazë të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Lezhë, ndodhet në Njësinë Strukturore BL-B-016. Përdorimet e lejuara të territorit të kësaj njësie janë:

Kategoria 1: B. Bujqësi;

Kategoria 2: A. Banim, S. Shërbime, IE. Industri dhe Ekonomi, SH. Shëndetësi; Lartësia në kate: 2.5 kat;

Lartësia në metra: 9.5 metra; PDV: Leje Zhvillimi




Fig. Nr. 18 Ekstrakt nga PPV-ja Lezhë

Përsa i përket objektit ekzistues, punimet që kërkohen të kryhen janë vetëm punime riparimi dhe mirëmbajtje, të cilat klasifikohen si punime që nuk kanë nevojë për pajisje me Leje Ndërtimi, referuar neneve nr. 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 408/2015 (i ndryshuar).

Ndërkohë, shtimi i një objekti të ri kërkon pajisjen me Leje Zhvillimi dhe Leje Ndërtimi, në përputhje me përcaktimet e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Lezhë.

Objekti ekzistues, si Monument Kulture i Kategorisë së Dytë, kërkon gjithashtu pajisjen me aprovimin përkatës nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale.

Pajisjet me leje për kryerje punimesh, në ndryshim nga Planet e Përgjithshme dhe ato të Detajuara Vendore, nuk kërkojnë konsultime me publikun.

Përsa i përket raportit të shpronësimeve, objekti ku ndodhet banesa që do të muzealizohet është pronë private. Referuar geoportalit ASIG, kjo pronë ka numër 202/20, zona kadastrale 1624.




Fig. Nr. 19 Foto nga Asig

Fig. Nr. 1	Shtëpia ku ka jetuar vitet e para	3
Fig. Nr. 2	Koncepti i muzealizimit të hapësirës.....	4
Fig. Nr. 3	Koncepti i organizimit të odave	5
Fig. Nr. 4	Plan Sistemimi	7
Fig. Nr. 5	Render nga objekti i propozuar	8
Fig. Nr. 6	Render nga objekti i propozuar	8
Fig. Nr. 7	Render nga objekti i propozuar	9
Fig. Nr. 8	Render nga objekti i propozuar	9
Fig. Nr. 9	Foto e objektit në pjesën e pasme të oborrit	10
Fig. Nr. 10	Skema e organizimit funksional.....	11
Fig. Nr. 11	Oda 1.....	12
Fig. Nr. 12	Oda 2.....	13
Fig. Nr. 13	Korridori i katit përdhe	14
Fig. Nr. 14	Korridori i katit të parë.....	15
Fig. Nr. 15	Oda 3.....	15
Fig. Nr. 16	Oda 4.....	16
Fig. Nr. 17	Oda 5.....	17
Fig. Nr. 18	Ekstrakt nga PPV-ja Lezhë	18
Fig. Nr. 19	Foto nga Asig.....	19